



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Primjeno / Podato Received / Delivery	13-12-2023	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTICK	7450/2023		113



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1414/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1414/2023 të datës 15.11.2023 të parashtruar nga ankuesja

kundër Vendimit KA.Nr.36/2023 të datës 13.10.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 13.12.2023, mori këtë:

### V E N D I M

**HEDHET** poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1414/2023 e datës 15.11.2023 e parashtruar nga ankuesja

### A r s y e t i m

Udhëheqësi i Zyrës së Pagave, Udhëheqësi i Zyrës për Përkthim dhe Lekturim dhe Udhëheqësi i Zyrës për Transport në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, më datës 19.09.2023 kanë parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me pretendimet për zbatim të Rregullos N. 02/2023 për Veprimtarinë, Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Administratës në Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës më datë 13.10.2023 ka nxjerr Vendim KA.Nr.36/2023 me të cilin ka aprovuar pjesërisht ankesën e palëve ku ka aprovuar pretendimin për kompensim retroaktiv të beneficioneve përkritazi me pozitat e tyre nga data e hyrjes në fuqi të rregullosës së lartcekur, ndërsa ka refuzuar pretendimin për caktim në pozitat e udhëheqësve të divizionit sepse me vendimin e datës

09.10.2023 janë caktuar përkitazi me pozitat e reja si udhëheqës të Divizioneve, ku është obliguar u.d Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës si dhe Zyra e Burimeve Njerëzore të zbatojnë pikën I të këtij vendimi.

Ankuesja në cilësinë e ushtrueses së detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, përmes emailit [ankesa.kpmsk@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmsk@rks-gov.net), më datë 14.11.2023 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila më datë 15.11.2023 dhe është regjistruar më numër të ankesës A.nr.1414/2023, me numër protokollit 6978/2023, kundër Vendimit KA.Nr.36/2023 të datës 13.10.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.11.2023 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankueses nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës. Ndërsa Këshilli më datë 22.11.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave (në tekstin në vijim Kolegji i Këshillit), duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankueses, është e palejuar, *sepse:*

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.Nr.36/2023 të datës 13.10.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ka kërkuar që ky vendim të shfuqizohet apo të anulohet.

Lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankueses dhe se kush konsiderohet palë në procedurë administrative, Kolegji ju referua nenit 14 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sipas të cilit përcaktohet se: *“Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenohet të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative”*. Ndërsa me nenin 124 po të njëjtit Ligj parashihet se: *“Pala ka të drejtë të ushtrojë mjete juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim. Anëtar i një organi kolegjal, ka gjithashtu të drejtën të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi procedural të organit kolegjal, nëse pretendon se një nga dispozitat e neneve 37-43 të këtij Ligji janë shkelur nga një veprim apo mosveprim i tillë...”*, Andaj në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, Kolegji i Këshillit vlerëson se me vendimin e kundërshtuar me ankesë, nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankueses, gjegjësisht ankuesja nuk ka legjitimitetin e palës për të parashtruar ankesë kundër Vendimit KA.Nr.36/2023 të datës 13.10.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit

Prokurorial të Kosovës, rrjedhimisht bazuar në këtë konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhë se ankesa A.nr.1414/2023 e parashtruar nga ankuesja është e papranueshme.

Nga ajo që u konstatue si më lartë, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda,A.nr.1414/2023, datë 13/12/2023

**Avdyll BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Arben MEHMETI**

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.